

Murtezan Idrizi, MA<sup>1</sup>

UDC:  
37.043.2-054(=18)(091)

**SHKOLLAT E MEJTEREVE – KUPTIMI, HISTORIKU DHE ROLI I  
TYRE NË SISTEMIN EDUKATIVO-ARSIMOR**

**УЧИЛИШТАТА МЕКТЕБИ – ЗНАЧЕЊЕТО, ИСТОРИЈАТА И  
НИВНАТА УЛОГА ВО ВОСПИТНО-ОБРАЗОВНИОТ СИСТЕМ**

**MAKTAB SCHOOLS – THEIR MEANING, HISTORY AND ROLE  
IN THE EDUCATION SYSTEM**

**Abstract**

Historically the maktebs have played a crucial law in the development of the educational process for the young generations of the Muslim population within the border of the Ottoman Empire. They are stretched in the territories of Balkans as was the Ottoman Empire expanding its territories. In this paper we will regards a couple of aspects of the development of maktebs, starting from the semantic meaning of the word makteb, and reaching to the organisational aspects of this significant educational institution during the Empire era.

The notion “mekteb” derives from Arabic language, the root of the verb “katabe” , that means “writes”, and the semantic meaning of the notion “makteb” is classroom, school. So it means school, where the children obtain the initial knowledge. The Turkish author Mustafa Ozer, referes to 27 maktebs in Skopje area and Evliya Chelebi in his “Seyahatname” notes around 70 maktebs in Skopje.

The curricula in maktebs have been changed through years starting from the beginning to the end the Ottoman Empire in 1924. What remained unchanged in these schools was learning Quran and the

---

<sup>1</sup> Doktorant i historisë në Universitetin e Sakarias në Turqi dhe hulumtues shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. E-mail: m\_idrizi001@hotmail.com

reading rules. However, beside Quran the learning of Islamic primary rules was learned as well.

Since Albanian children had no school in their mother tongue, they were going in maktebs and learning the Arabic alphabet, some of Islamic rules, including the learning of some Islamic faith and learned by hart some parts from the Quran, necessary for performing the daily prayers.

Historikisht, mejtepet kanë luajtur rol të madh në zhvillimin e procesit edukativo-arsimor tek gjeneratat e reja të popullsisë së fesë islame brenda kufijve të Perandorisë Osmane. Ato janë shtrirë edhe në teritoret tona ballkanike bashkë me shtrirjen e osmanlinjve në këto anë.

Në vijim do të shohim disa aspekte të zhvillimit të mejtepeve, duke filluar që nga kuptimi termologjik i fjalës mejtep, e deri te aspektet organizative të këtij institucioni të rëndësishëm edukativo-arsimor gjatë kohës së Perandorisë Osmane.

Termi “mejtep” rrjedh nga gjuha arabe, përkatësisht nga rrënja e foljes “keteb” që donë të thotë “shkruan”, kurse kuptimi i termit “mejtep” është për një mësojtore, përkatësisht shkollë<sup>2</sup>. Pra, shkollë ku fëmijët merrnin njohurit fillestare<sup>3</sup>. Edhe më herët te arabët shkolla quhej “kyttab”<sup>4</sup>, vendi apo objekti ku fëmijët pajiseshin me dituri<sup>5</sup>. Ngjashëm është sqarimi edhe në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, ku fjala “Mejtep” nënkupton “shkollë fillore, ku jepej edhe mësimi i fesë për besimtarët myslimanë”<sup>6</sup>.

Që nga koha e profetit Muhamed këto vende ku fëmijët mësonin shkrim-leximin dhe Kur’anin quheshin Kyttab (shkolla). Në kohën e osmanlinjve, ky emër u shndërrua në “mekteb sibjan” apo shkolla për fëmijë, por kishte edhe emra të tjerë që përdroreshin. Pas shekullit XIX-të, kuptimi i institucionit mejtep më vonë zgjerohet, dhe çdo institucion arsimor emërtohej me këtë emër<sup>7</sup>. Lirisht mund të themi se mejtepet atëherë ishin një lloj shkolle parafillore dhe fillore. Fëmijët që ndiqnin mësimin nëpër mejtepe, ndryshe quheshin “talebe” (nxënës), me kuptimin

<sup>2</sup> Nebi Bozkurt, İslam Ansiklopedisi, Mektep, Cilt 29, Türkiye Diyanet Vakfi, Ankara, 2004, 5-6.

<sup>3</sup> Fehmi Yılmaz, Osmanlı Tarih Sözlüğü, Gökkube, İstanbul, 2010, 413.

<sup>4</sup> Mehmed Maksudoglu, Historia osmane dhe institucionet, Për: Enilda Mejdani, Alsar, Tiranë, 2013, 690.

<sup>5</sup> Naser Ramadani, Depërtimi osman në Maqedoni dhe zhvillimi i arsimit islam gjatë shekujve XV-XVI, BIM Shkup, 1998, 81.

<sup>6</sup> <http://www.fjalorshqip.com/>

<sup>7</sup> Nebi Bozkurt, 5-6.

“kërkues i dijes”<sup>8</sup>. Në vendet ku ende nuk ishte ndërtuar mejtepi, mësimi zhvillohej në hapësirën e faltores (xhamisë)<sup>9</sup>.

Në Ballkan, mejtepet si institucione arsimore datojnë që në fillimin e depërtimit të osmanlinjve, edhe atë menjëherë pas xhamive. Kjo nënkupton se ardhja e osmanlinjve në Ballkan solli edhe familje nga Anadulli, me ç’rast u ndje nevoja e themelimit të mejtepeve për arsimimin e fëmijëve të tyre<sup>10</sup>. Meqë nuk mund të gjejmë gjurmë apo dokumentacione që vërtetojnë kohën e ndërtimit, nuk do të kalkulojmë me shifra. Por është fakt që në pjesën e dytë të shekullit të XVIII–të dhe në përgjithësi në shekullin e XIX–të, ndërtimi i mejtepeve ishte i prani-shëm. Autori turk Mustafa Ozer, në librin e tij për Shkupin, përmendë diku 27 mejtepe me emër origjinal, njashtu duke iu referuar veprës së Evlia Çelebiut “Udhëpërshkrimi”, ku theksohet se në kohën e tij në Shkup kishte diku rreth 70 mejtepe<sup>11</sup>.

Mejtepet ndërtoheshin nga udhëheqësit, sulltanët, administratorët me poste të larta në Perandorinë Osmane. Për harxhimet arsimore të mejtepeve themeloheshin vakëfe. Por kishte raste të veçanta kur ndërtoheshin mejtepe enkas për fëmijët jetim dhe të varfër<sup>12</sup>. Një gjë nuk duhet harruar se vakëflënësi kishte angazhim të madh për ndërtimin e mejtepeve. Një gjë të tillë e bënin edhe zejtarët, tregtarët dhe dijetarët<sup>13</sup>. Këto institucione ndërtoheshin nëpër çdo qytet dhe në ç’do fshat të madh, edhe atë ku kishte më së shumti pjesëtarë të fesë myslimane, dhe aty mësonin fëmijët. Në realitet, funksioni i mejtepeve ishte i lidhur ngushtë me xhamitë apo mesxhidet, ku edhe formohej vetë lagjja<sup>14</sup>. Zakonisht, objektet e mejtepeve ndërtoheshin afër xhamive, edhe pse kishte përjashtime<sup>15</sup>.

### **Vijimësia e mësimimit në mejtepe**

Që nga fillimi i Perandorisë Osmane e deri në vitin 1924, programi mësimor nëpër mejtepe hasi në shumë ndryshime thelbësore.

<sup>8</sup> Јенуз Ибрахими, Мектебите и медресите во Македонија во времето на Османлиското владеење (до крајот на XVIII век), Скопје, 2013, 47.

<sup>9</sup> J. Ибрахими, 46.

<sup>10</sup> N.Ramadani, 82.

<sup>11</sup> Mustafa Özer, Üsküp’teki Türk Mimarisi (XIV. – XIX. YÜZYIL), TTK, Ankara 2006, 288.

<sup>12</sup> N.Bozkurt, 5-6.

<sup>13</sup> N.Ramadani, 83.

<sup>14</sup> J.Ибрахими, 45.

<sup>15</sup> N.Ramadani, 90.

Por ajo që nuk ndryshoi nëpër këto shkolla, ishte të mësuarit e leximit të Kuranit me rregullat e tij. Megjithatë, në vitet në vijim, përveç Kuranit, filloi edhe mësimi i rregullave elementare të Islamit. Kjo traditë e mejtepeve ka vazhduar deri në ditët tona, meqë edhe sot nëpër mejtepe fëmijëve iu mësohen njohuritë elementare të fesë Islame dhe leximi i Kuranit<sup>16</sup>.

Kah fundi i sulltanatit osman, apo më prerë në vitin 1838, mejtepet ndahen në dy grupe: mejtepe me hapësira të vogla dhe mejtepe me hapësira të mëdha. Në grupin e parë bënin pjesë mejtepet e mëhallave, ku mësohej vetëm leximi i Kuranit, kurse në grupin e dytë bënin pjesë mejtepet që zakonisht ndërtoheshin afër xhamive, dhe përveç leximit të Kuranit mësoheshin edhe bazat elementare të fesë, si shkrimi, përlllogaritja, historia, gjeografia dhe disa lëndë tjera. Kurse, në bazë të plan-programit mësimor, mejtepet mund të ishin: mejtepe ku mësohej shkrim-leximi dhe leximi i Kur'anit, si dhe mejtepe ku mësoheshin lëndët tjera<sup>17</sup>.

Ndryshe nga ky klasifikim, kah fundi i shekullit të XIX-të, hapen mejtepe me emrin Iptida'i (parashkollore), që ndryshe njihen me emrin "Mektebi sibjan". Fëmijët që mbushnin katër vjet e gjysmë, dërgoheshin për të mësuar njohuritë e para apo siç dihet leximin e Kur'anit. Pas kalimit të dy-tri viteve në këtë shkollë, fëmijët përgatiteshin për shkollën normale - mejtep<sup>18</sup>. Faza tjetër e shkollimit ishte mejtepi Rushdije (faza e maturimit), që sot vlerësohet si një shkollë e mesme<sup>19</sup>. Të këtij lloji, në vitin 1906-1907 në Shkup kishte dhjetë shkolla, ndërsa njëra prej tyre ishte për femra<sup>20</sup>. Në këtë të fundit kishte mësimdhënëse femër<sup>21</sup>. Nga një version tjetër na rrëfëhet se ekzistonin edhe këto ndarje: të veçanta për femra, të veçanta për djem dhe të përziera<sup>22</sup>.

Nga historia na është e njohur se deri në fund të Perandorisë Osmane fëmijët në mejtepe mësonin të ndarë meshkujt nga femrat. Por, kah fundi i shekullit të XIX-të, shohim se fëmijët meshkuj dhe femra kanë mësuar bashkë në të njëjtin mejtep. Vijimi i mësimëve në mejtep ishte e përcaktuar të zgjaste 4 vite. Në vitin 1868-të në bazë të ligjit,

<sup>16</sup> Cahit Balltaç, 6-7.

<sup>17</sup> F. Yılmaz, 413; J.Ибрахими, 50; N.Ramadani, 87.

<sup>18</sup> M.Maksudoglu, 689.

<sup>19</sup> F. Yılmaz, 553.

<sup>20</sup> M.Özer, 288.

<sup>21</sup> J.Ибрахими, 55.

<sup>22</sup> N.Ramadani, 86.

fëmijët meshkuj që mbushin shtatë vjet ishin të detyruar të shkojnë në mejtep, kurse femrat në moshën gjashtë vjeç. Kjo tregonte moshën obligative për vajtje në mejtep<sup>23</sup>. Rreth vajtjes në mejtep për moshën ka versione të ndryshme, se ka qenë ndërmjet asaj 5-6-7 vjeçare, por qëndron mundësia të kenë mësuar edhe adoleshentët<sup>24</sup>. Një version na thotë se mësimi në mejtep fillon që në moshën katër vjeçare, ku nuk precizohet koha se kur përfundonte kursi nëpër mejtepe<sup>25</sup>.

Numri mesatar i fëmijëve që shkonin në mejtep arrinte diku 30-40 nxënës, ashtu që mësohej me dy ndërrime, duke filluar nga ora tetë e deri në mesditë, kur ishte edhe koha e ushqimit dhe pushimit. Pastaj fillonte ndërrimi i dytë dhe vazhdonte deri në mbrëmje apo në darkë<sup>26</sup>.

### **Mësimdhënësit nëpër mejtepe**

Në realitet kuadri mësimdhënës në mejtepe përbëhej nga dy persona, i pari ishte mësimdhënësi ose hoxha (mualim) dhe i dyti ishte asistenti i tij (halifi apo kalfa)<sup>27</sup>. Mësimdhënësi paguhej gjashtë dërrhem, kurse asistenti katër dërrhem. Por kjo mund të ndryshonte nga vendi në vend<sup>28</sup>. Vlen të theksohet se i pari apo mësimdhënësi kishte edhe një detyrë tjetër, në vendet ku nuk kishte imam në xhami, ky bënte edhe detyrën e imamatit. Kurse i dyti apo asistenti ushtronte detyrën e myezinit në xhami<sup>29</sup>.

Rroga e mësimdhënësit sigurohej nga vakëfi, institucion i cili në raste festash i shpërblente nxënësit edhe me veshje<sup>30</sup>. Veçoria që kërkohet nga mësimdhënësi ishte ajo se ata duhej të jenë njerëz të dalluar me moral, të jenë të ditur dhe mos të kenë asnjë pikë të zezë në karrierën e tyre<sup>31</sup>. Me theks të veçantë, mësimdhënësi duhej të ishte lexues i mirë i Kuranit, t'ua mësojë fëmijëve Kuranin me përsëritje akustike. Njëkohësisht mësimdhënësi duhej të jetë i aftë për arsimim, i ditur në sintaksë, gramatikë dhe bukurshkrim<sup>32</sup>.

<sup>23</sup> C.Balltaç, 6-7.

<sup>24</sup> N.Ramadani, 91; M.Maksudoglu, 690.

<sup>25</sup> J.Ибрахими, 47.

<sup>26</sup> По ату, 48.

<sup>27</sup> J.Ибрахими, 51; M.Maksudoglu, 690.

<sup>28</sup> По ату, 52.

<sup>29</sup> По ату, 55.

<sup>30</sup> По ату, 47.

<sup>31</sup> По ату, 48.

<sup>32</sup> N.Ramadani, 88-9.

Gjithashtu, na bëhet e ditur se mësuesi mbante rendin dhe qetësinë në klasë me një thupër në dorë, ku në raste të veçanta i qortonte fëmijët<sup>33</sup>. Mësimdhënësit që punonin nëpër mejtepe, nëse dëshironin të avancohen për në medrese, duhej të merrnin mësim special për këtë<sup>34</sup>.

### **Efekti i mbarëvajtjes së mësimin në mejtepe**

Edhe pse një kohë të gjatë në Perandorinë Osmane nuk ishte e patjetërsueshme shkuarja në mejtepe për të gjithë fëmijët, në vitin 1824 Sulltan Mahmudi i II-të, miratoi një ferman me të cilin i obligoi prindërit që t'i dërgojnë fëmijët në mejtepe, për ndryshe do të dënoheshin për moskujdesin<sup>35</sup>. Ndër rolet më të rëndësishme të mejtepit ishin: e para, fëmijët të mësojnë bazat e fesë, atë pjesë që e kanë praktikuar prindërit e tyre, dhe e dyta, fëmijët të mësojnë shkrim-leximin fillestar<sup>36</sup>.

Njëkohësisht, roli i mejtepit ishte pajisja e fëmijëve me dituri të Kuranit, shkrim-leximit, dhe njëkohësisht përforcimin e moralit të njerëzimit. Nuk ka argumente që vërtetojnë mësimin e lëndëve natyrore në mejtepe<sup>37</sup>, lëndë që me siguri do të jepnin efektet e duhura. Një ndër rolet që luante mejtepi, ishte se fëmija që mësonte në mejtepe sistemohej në programin arsimor, që në të ardhmen të vazhdojë mësimet edhe në medrese<sup>38</sup>.

Fëmija që përfundonte mejtepin ishte shumë profesional në pikëpamjen teorike dhe praktike të fesë Islame. Me një fjalë, ishin shumë konservator në mbarëvajtjen e fesë, edhe pse njohuritë që posedonin ishin të kufizuara, por me moral të lartë. Për dallim nga ato, mejtepet e sotit dallojnë në disa prizma. Fëmijët që shkojnë në mejtepe, njëkohësisht shkojnë edhe në shkolla fillore shtetërore, dhe paralelisht furnizohen me njohuri të ndryshme. Në këtë rast, ana teorike e fesë është më e fuqishme se sa ajo praktike, ndërsa fëmijët nuk janë aq konservator në mbarëvajtjen e obligimeve fetare.

Fëmijët shqiptarë me që nuk kanë pasur asnjë shkollë në gjuhën amtare, ata shkonin në mejtepe ku mësonin përmendësh alfabetin arab, diçka nga kushtet e besimit Islam, si dhe disa pjesë nga Kur'ani që ishin

<sup>33</sup> J.Ибрахими, 49.

<sup>34</sup> С.Валлас, 6-7.

<sup>35</sup> J.Ибрахими, 48.

<sup>36</sup> По ату, 45.

<sup>37</sup> N. Ramadani, 92.

<sup>38</sup> J.Ибрахими, 48.

mase të nevojshme për kryerjen e obligimeve fetare<sup>39</sup>. Në përgjithësi në mbretërinë Jugosllave mungonte arsimit shqip, kështu që në formë jo legale fëmijët shqiptarë për t'u edukuar në gjuhën e tyre zgjidhnin mejtepet, të cilët më vonë u shndërruan në shkolla shqipe, sepse mësimdhënësit ishin me shumicë shqiptarë<sup>40</sup>.

Si në shkollat shtetërore ashtu edhe në ato private pati patriot të mirë të cilët, krahas mësimi fetar, tinëz ose haptazi e zhvilluan edhe atdhedashurinë të nxënësit e vet shqiptarë, e kultivuan gjuhën amtare, disi shkruan edhe poezi edhe ilahi në gjuhën shqipe me alfabet arab. Në këtë mënyrë gjithmonë e mbajtën të gjallë vetëdijen për vetveten duke e ruajtur në këtë mënyrë identitetin kombëtar<sup>41</sup>. Kujtoj se kultivimi i këtij lloji arsimit, ishte dhe është i një rëndësie të veçantë në kanalizimin e të riut për një të ardhme konservatore edhe fetare po edhe kombëtare.

### Conclusion

The children to graduate from maktab were very professional in terms of theoretical practical knowledge of Islamic religion. In other word they had very conservative thoughts about the religious discourse. Despite their limited knowledge on faith, they possessed high moral values. Nowadays maktab differ greatly from those at Ottoman era. Children of our contemporary era that go to maktab, at the same time go to elementary public schools so simultaneously they obtain different type of information. In this context the theoretical knowledge on religion is stronger than the practical and the children do not have those high conservative views.

Generally speaking during the Kingdome of Yugoslavia there was lack of education in Albanian language. Due to that through the informal way Albanian children continued visitng maktab in order to obtain education in their mother tongue, that later on were transformed to Albanian school, since the majority of teachers were Albanians<sup>42</sup>.

Good patriots were found in public and in private schools that apart from the religious education have covertly or in disclosed way

<sup>39</sup> Musli Bajrami, Periudha historike e Medresesë së Isa Beut, Autori, Shkup, 2005, 75.

<sup>40</sup> Simpozium shkencor, Kontributi i Ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare, BFI, Shkup, 2013, Qerim Lita, Medresetë e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup gjatë sundimit të Mbretërisë së SKS (Jugosllave) f. 108-119.

<sup>41</sup> M.Bajrami, po aty, 74.

<sup>42</sup> Simpozium shkencor, Kontributi i Ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare, BFI, Shkup, 2013, Qerim Lita, Medresetë e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup gjatë sundimit të Mbretërisë së SKS (Jugosllave) fq. 108-119.

instigated the love for the motherland among the Albanian students, utilised the mother tongue, or have written poetries and poems with religious subject, written in Albanian language with ottoman alphabet. In this manner they have permanently kept alive the self-awareness and protected the national identity<sup>43</sup>. I consider that this type of education was highly significant for the education of the youth in the spirit of conservative, religious and national education.

### **Literatura e konsultuar**

- Cahit Balltaç, İslam Ansiklopedisi, Osmanlılar'da Mektep, Cilt 29, Türkiye Diyanet Vakfı, Ankara, 2004.
- Fehmi Yılmaz, Osmanlı Tarih Sözlüğü, Gökkube, İstanbul, 2010.
- Јенуз Ибрахими, Мектебите и Медресите во Македонија во Времето на Османлиското Владеење (до крајот на XVIII век), Фуркан ИСМ, Скопје, 2013.
- Mehmed Maksudoglu, Historia Osmane dhe Institucionet, Për: Enilda Mejdani, Alsar, Tiranë, 2013.
- Mustafa Özer, Üsküp'teki Türk Mimarisi (XIV. – XIX. YÜZYIL), TTK, Ankara, 2006.
- Musli Bajrami, Periudha Historike e Medresesë së Isa Beut, Autori, Shkup, 2005.
- Naser Ramadani, Depërtimi Osman Në Maqedoni dhe Zhvillimi i Arsimit Islam gjatë shekujve XV-XVI, Mëshlisi Shura, Shkup, 1998.
- Nebi Bozkurt, İslam Ansiklopedisi, Mektep, Cilt 29, Türkiye Diyanet Vakfı, Ankara, 2004.
- Simpozium Shkencor, Kontributi i Ulemave në Ngritjen e Çështjes Kombëtare, BFI, Shkup, 2013, Qerim Lita, Medreset e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup Gjatë Sundimit të Mbretërisë së SKS (Jugosllave) fq. 108-119.

---

<sup>43</sup> M.Bajrami, po aty, 74.